

Emri i Lëndës : E Drejtë Penale e Krahasuar							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 535	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Ermira Tafani, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Lënda E Drejta Penale e Krahasuar ka si qëllim t'u shërbejë studentëve dhe juristëve, për t'i pajisur ata me kulturën e institucioneve dhe instituteve të së drejtës penale të vendeve të ndryshme. Studimi i kësaj disipline, përbën një parakusht për të kuptuar dhe paraprirë evolucionin e së drejtës së brendshme. Trualli në të cilën operon kjo disiplinë janë legjislacionet penalo – procedurale të huaja. Studimet e krahasuara përbëjnë bazën e njohjes së ligjit të huaj dhe për pasojë të përmirësimit e unifikimit të tendencave pozitive në zhvillimet e ndryshme legjislative. Në kuadrin e kësaj disipline, pasqyrohen në mënyrë kronologjike procesi i lindjes dhe zhvillimit të traditave të ndryshme ligjore në lëmin penal. Studimet e krahasuara kanë filluar të zhvillohen jo shumë hershëm dhe nuk kanë rreshtur deri në ditët tona kur prirja e integritetit sidomos për Shqipërinë, ngre në rend të ditës standarte të krahasueshme me anëtarët e tjerë komunitarë që përbëjnë atë që në terma të tjerë njihet si “Evropa Juridike”. Kjo disiplinë tenton të krijojë një tablo të qartë të sistemeve kryesore të së drejtës penale në Evropë e më gjerë.					
Objektivat		Studentet të kenë njohuri të përgjithshme mbi lëndën. Studentet të kenë aftësi të krahasojnë të drejtën penale të brendshme të Shqipërisë me ato të shteteve të huaja.					
Konceptet Kryesore		1. E drejtë Penale e Krahasuar 2. Konventa 3. Tradita juridike 4. Sisteme ligjore 5. Aktorët e procesit penal					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	- Trajtime të përgjithshme mbi të drejtën penale krahasuar; - Përkufizimi i të drejtës penale të krahasuar. - Objekti i studimit të së drejtës penale e krahasuar.						
2	- E drejta penale e krahasuar si një disiplinë juridike dhe shkencore; - Karakteristikat e të drejtës penale të krahasuar.						
3	- Faktorët që favorizojnë studimin e së drejtës penale të krahasuar - Historia e të drejtës krahasuese me theks të veçantë të drejtës penale të krahasuar						
4	- Marrëdhëniet midis të drejtës penale të krahasuar dhe disiplinave të lidhura (debat me studentë) - Sanksionet penale, në sistemet juridike penale të vendeve të ndryshme;						
5	- Burimet e së drejtës penale të krahasuese (burimet kryesore konventat, kushtetutat, kodet, e drejta zakonore, praktika gjyqësore).						
6	- Prezantimi nga aspekti i zgjidhjeve të përfshira në dokumentet ndërkombëtare (rezolutat, konventave, protokolleve, statuteve dhe akteve të tjera) dhe në kodet penale të vendeve të ndryshme						
7	Metodat e studimit të së drejtës penale të krahasuar: - Krahasimi i instituteve të së drejtës krahasuese me një vështrim të veçantë në institutet e të drejtës penale si vepra penale, përgjegjësia penale, vendi dhe koha e kryerjes së veprave penale, ekstradimi, mbrojtja së nevojshme, etj.						
8	Provim gjysmefinal Detyrë kursi						

9	Sistemi britanik - Parimet, burimet, institutet, sanksionet penale. (Diskutim me studentët). - Krahasset e këtij sistemi me familjet e tjera të sistemeve juridike
10	- Sistemi i së drejtës penale në vendet skandinave, Sistemi i së drejtës penale në disa vende të Evropës: Itali, Gjermani, Francë, etj
11	- Sistemi Holandez, Belg, - Karakteristikat e këtij sistemi - Analiza e disa institucioneve themelore të ligjit penal të këtyre shteteve (pjesa e përgjithshme, pjesa e veçantë, veprat penale, sanksionet penale dhe llojeve të tyre).
12	E drejta penale në SHBA, Analiza e disa institucioneve themelore të ligjit penal të këtij shteti (pjesa e përgjithshme, pjesa e veçantë, veprat penale, sanksionet penale dhe llojeve të tyre).
13	E Drejta penale në vendet e Amerikës Latine (Argjentinë, Brazil, etj) Analiza e disa institucioneve themelore të ligjit penal të këtyre shteteve (pjesa e përgjithshme, pjesa e veçantë, veprat penale, sanksionet penale dhe llojeve të tyre).
14	E Drejta penale në vendet e Lindjes. Analiza e disa institucioneve themelore të ligjit penal të këtyre shteteve (pjesa e përgjithshme, pjesa e veçantë, veprat penale, sanksionet penale dhe llojeve të tyre).
15	Sistemet e procedimit penal; Karakteristikat e procedurave penale inkuizitore dhe akuzatore (Ross. Mary Ann. Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri : raport i Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë. Tiranë : OSCE, 2006.,)
16	Provim Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Heller, Kevin Jon. Dubber, Markus (eds). Comparative Criminal Law. Stanford: Stanford University Press: 2011. • Altin Shegani, E Drejta Penale e Krahësuar, Tiranë 2011 • 3. Ross. Mary Ann. Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri : raport i Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë. Tiranë : OSCE, 2006	
Referenca të tjera	
• Richard J. Terrill, World Criminal Justice Systems: A Comparative Survey, Routledge, 2012 • Lauterwien, Carl Constantin. The limits of criminal Law, a comparative analysis of approaches to legal theorizing. England: Ashgate publishing, 2010. • Ross. Mary Ann. Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri : raport i Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë. Tiranë : OSCE, 2006.	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të kenë aftësinë për të kuptuar faktin se në botën moderne është vështirë të imagjinohet miratimi e ligjeve sistemore (kodeve) në çdo fushë, duke përfshirë të drejtën penale, pa mbështetjen në ,modelet krahasuese.
2	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të kenë aftësinë për të formuar një koncept mbi të drejtën penale krahasuese dhe rolin e saj në avancimin e sistemit të drejtësisë penale dhe efikasitetin e luftimit të kriminalitetit.
3	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të kenë aftësinë për të formuar bindjen se institucionet e së drejtës penale të krahasuar (vepra penale, përgjegjësisë penale dhe sanksioneve penale) janë institucione me interes të lartë për të gjithë botën, në Evropë, në rajon, por edhe për Kosovën dhe qytetarët e saj.
4	Studenti do të njohë aktorët e sistemeve të drejtësisë, figura të ndryshme të veprave penale nga më komplekset me të cilat përballët aktualisht realiteti shqiptar dhe ai botëror.
5	Pas përfundimit të këtij kursi, Studenti duhet të njohi sistemet e ndryshme penale në botë.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	20	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	6	84
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	1	1
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			151
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.04
ECTS			6.00